



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

**KRYETARI I KOMUNËS**

01. Nr. 162/01-0132297, më 02. 06. 2017

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, lëshon këtë:

**U R D H Ë R E S Ë**

- I. URDHËROHET Drejtoria e Urbanizmit ta lirojë nga taksa për Leje Ndërtimore Kishën Protestante "Bashkësia Ungjillore e Mesisë".
- II. Lirimi nga taksa për leje ndërtimore ka të bëjë me ndërtimin e objektit në parcelat kadastrale 110-2, 110-4, 155-2, 155-4 dhe 155-20 ZK Sofali, i cili do të shërbejë për nevojat e Kishës Protestante "Bashkësia Ungjillore e Mesisë".
- III. Për zbatimin e kësaj urdhëresë obligohet Drejtoria e Urbanizmit.
- IV. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj.

**A r s y e t i m**

Kisha Protestante "Bashkësia Ungjillore e Mesisë", ka aplikuar për leje ndërtimore në Drejtorinë e Urbanizmit, për ndërtimin e objektit në parcelat kadastrale 110-2, 110-4, 155-2, 155-4 dhe 155-20 ZK Sofali, i cili do të shërbejë për nevojat e Kishës së lartëcekur.

Parcelat e lartëcekura ku do të ndërtohet objekti janë në pronësi të Kishës Protestante "Bashkësia Ungjillore e Mesisë", dhe objekti që do të ndërtohet në këto parcela do t'i takojë Kishës, ku në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare janë vende të kultit dhe si të tilla janë objekte fetare.

